



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:284049

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753479

KE.nr.55/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit Korporata Energjetike e Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit M.B.F., me vendbanim në Mitrovicë, rruga “Zef Kozhara”, me objekt kontesti kompensim i dëmit, jashtë seancës me datën 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm dhe Gjykatës Komerciale të Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Paditësi Korporata Energjetike e Kosovës SH.A., me datë 17.03.2019, ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurit M.B.F., në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin C.nr.125/2017, të datës 18.12.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje dhe lëndën e ka dërguar për vendosje në Gjykatën Komerciale të Kosovës, me arsyetim së në kuptim të dispozitave nga neni 13 të Ligjit 06/L-015 për Gjykatën

Komerciale, Gjykata Komerciale e Kosovës është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare, ndërmjet personave juridik publik dhe privat në çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre.

Gjykata duke u bazuar në nenin 13 par. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, vlerëson se në rastin konkret është kompetente pikërisht Gjykata Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, për faktin se në rastin konkret i padituri është person fizike, ndërsa Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale është kompetent për të vendosur kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate.

Andaj Gjykata Komerciale e Kosovës duke vepruar sipas dispozitës së nenit 24 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke hapur konfliktin e kompetencës në këtë çështje juridike kontestimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.55/24, datë 29.05.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.